



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr.\_\_\_\_Prot.

Tiranë, më\_\_\_\_.03.2023

**MBLEDHJA Nr. 13,**  
**Datë 20.03.2023, ora 10:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 20.03.2023, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 12 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalëve të mbledhjeve të bordit të ERE-s datë 13.03.2023 dhe 15.03.2023.
2. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e ndryshimeve në rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet ost sh.a. dhe përdoruesit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.04.2018
3. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
4. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “SUN ENERGY SOLUTIONS” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
6. Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE -s nr. 38, datë 20.02.2023 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energji-Xhaçi” shpk”.
7. Kërkesën e shoqërisë “SEKA HYDROPOWER” sh.p.k., për rishikimin dhe pezullimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 17, datë 06.02.2023 “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “SEKA HYDROPOWER” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw”.

8. Kërkesën e shoqërisë “SEKA HYDROPOWER” shpk për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, i ndryshuar.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**